



“TË DREJTAT PRONËSORE TË GRAVE NË KOSOVË”

“Mos Hesht”

► Qëllimi

Qëllimi i kësaj broshure është t'ju sigurojë grave të Kosovës informacion mbi të drejtat pronësore. Broshura është e ndarë në katër pjesë si në vijim: 1) një hyrje e përgjithshme mbi të drejtat pronësore; 2) informacion për të drejtën e trashëgimisë; 3) pasuria në martesë apo në bashkësi jashtëmartesore, dhe 4) një udhëzues për sistemin e ndihmës ligjore dhe informacione mbi qasjen në ligje. Broshura shpjegon masat mbrojtëse procedurale kryesore të cilat ju mundësojnë grave të identifikojnë metodat më të mira të mundshme për të realizuar të drejtat e tyre të pronësore, duke theksuar se ligji ju mundëson atyre që të jenë një forcë shtytëse për zbatimin e ligjeve të tilla.

► 1. Të drejtat pronësore në përgjithësi

Çfarë do të thotë pronësia?

Për të qenë një pronar i pronës do të thotë që JU mund të zotëroni, të përdorni dhe transferoni pronën brenda kufijve të përcaktuar me ligj dhe në përputhje me natyrën dhe qëllimin e objektit dhe interesit publik.

A janë Gratë dhe Burrat të barabartë në të drejtat pronësore?

PO! Ligjet e Kosovës garantojnë barazinë dhe jo-diskriminimin. E drejta për të qenë pronar i pronës i përket të dyve burrave dhe grave pa dallim.

Kushtetuta e Kosovës, ndër të tjera, garanton:

- barazinë para ligjit;
- të drejtën për të poseduar pronë;
- të drejtën për mjete juridike, për të kërkuar mbrojtje ligjore për të drejtat tuaja; dhe
- mbrojtjen kundër diskriminimit.

Ligjet e Kosovës garantojnë barazi midis grave dhe burrave në gëzimin e këtyre të drejtave.

► 2. E Drejta për Trashëgimi

Çfarë është trashëgimia?

Trashëgimia është kalimi i pasurisë së një personi të vdekur bazuar në ligj ose testament e atij personi

(trashëgimlënësit) tek një ose disa persona (trashëgimtarët). Arsyet për fitimin e trashëgimisë bazohen në ligj ose testament.

Kur fitohet trashëgimia?

Trashëgimia fitohet në momentin e vdekjes së personit. Në kushtet e parashikuara me ligj, çdo trashëgimtar i cili është i gjallë në kohën e trashëgimisë ose ndonjë person i cili është ngjizur para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lindur i gjallë brenda 300 ditëve pas vdekjes së trashëgimlënësit, mund të trashëgojë.

Për shembull: nëse ju jeni shtatzënë kur burri i juaj vdes dhe fëmija lind i gjallë, ky fëmijë po ashtu do të jetë trashëgimtar i tij.

A është ndarja e trashëgimisë më e madhe për burrat sesa gratë trashëgimtare?

JO! Secili trashëgimtarë sipas kushteve të njëjta është i barabartë në trashëgimi. Ligji nuk bën dallimin ndërmjet burrave apo grave. Ndarja e trashëgimisë është e bazuar në marrëdhënien tuaj (grua, motër, vëlla, fëmijë, etj) me trashëgimlënësin.

Për shembull: nëse trashëgimlënësi nuk ka pasur testament, bashkëshortja e tij dhe fëmijët do të trashëgojnë në pjesë të barabarta pronën në trashëgim. Fëmijët e tij/saj- meshkuj dhe femra - do të trashëgojnë pjesët e njëjta.

Çfarë duhet të di rreth procedurës trashëgimore?

Pas vdekjes së personit procedura trashëgimore hapet. Gjykata është organi kompetent për të kryer procedurën dhe për të vendosë për të drejtat e trashëgimisë.

Ju duhet të dini:

- Organi relevant komunal që mbanë librin amzë të të vdekurve është i detyruar - brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të vdekjes - të dërgojë certifikatën e vdekjes në gjykatë;
- Certifikata e vdekjes është shumë e rëndësishme për procedurën e trashëgimisë pasi që përmban të dhëna për personin e vdekur dhe për kohën e vdekjes; të dhëna për personat me të drejtën e mundshme për trashëgimi; dhe



“TË DREJTAT PRONËSORE TË GRAVE NË KOSOVË”

“Gra Thuani Fjalën Tuaj...”

informacionin mbi pronën që i përket personit të vdekur;

- Certifikata e vdekjes përgatitet në bazë të të dhënave të marra nga të afërmit e personit të vdekur; personat me të cilët personi i vdekur ka jetuar dhe persona të tjerë me informatat relevante të nevojshme për të kompletuar certifikatën e vdekjes;
- Sapo gjykata njoftohet se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim të gjykatës (në rastet kur personi ka qenë i zhdukur), gjykata fillon procedurën e trashëgimisë;
- Megjithatë, në praktikë, shumicën e rasteve procedurat gjyqësore fillojnë me paraqitjen e propozimeve nga palët e interesuara, dhe nganjëherë shumë vite pas vdekjes së personit.

Nëse gjykata nuk e fillon procedurën e trashëgimisë brenda afateve kohore ju mund të filloni këtë procedurë vetë. Është shumë e rëndësishme që procedura e trashëgimisë të kryhet sa më shpejt që është e mundur në mënyrë që të shmanget bartja e pronës dhe ashtu që trashëgimtarët të mund të gëzojnë pronën dhe përfitimet e saj.

Kush vendos për pjesën e trashëgimisë?

Gjykata kompetente vendos për pjesën e trashëgimisë, përveç në rastet kur ekziston një testament i përgatitur nga personi para se të vdiste. Testamenti është një shprehje e dëshirave përfundimtare të personit në lidhje me mënyrën se si ata dëshirojnë që pronat e tyre të shpërndahen pas vdekjes. Testamenti bëhet në formë të shkruar. Por në raste të veçanta testamenti mund të bëhet edhe gojarisht kur kriteri ligjor është plotësuar.

A duhet të heq dorë nga e drejta në trashëgimi?

JO! Çdo person mund, mirëpo askush nuk është i detyruar të heq dorë nga pjesa e tyre e trashëgimisë. Nëse një person nuk deklaron se heq dorë nga trashëgimia, ai/ajo ka të drejtë për të trashëguar pjesën e tij/saj të trashëgimisë.

Trashëgimtarët potencial femrat dhe meshkujt mund të heqin dorë nga të drejtat e tyre të trashëgimisë bazuar në dispozitat e ligjit. Por kjo duhet të bëhet vullnetarisht dhe jo nën presion. Nëse një trashëgimtar heq dorë nga e drejta e tij për trashëgimi, ai/ajo nuk do të ketë asnjë rol në lidhje me kthimin e kësaj pjese të trashëgimisë

kurrë më përsëri. Prandaj është jetike që JU të vendosni për këtë lirshëm dhe pa asnjë presion. JU çdoherë keni drejtë të mbani pjesën tuaj të trashëgimisë dhe askush nuk mund të ju shtyj të hiqni dorë prej saj.

3. Prona në Martesë dhe Bashkësi Jashtëmartesore

Unë jam i/e martuar – a kam të drejtë në pronë?

PO! Bashkëshortët në martesë janë të barabartë në të gjitha të drejtat e tyre. Ligji i Kosovës garanton se asnjëri prej bashkëshortëve nuk mund të privohet nga prona e tij/saj pa ndonjë bazë ligjore.

Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të gjinive të ndryshme, përmes së cilës ata lirshëm vendosin të jetojnë së bashku me qëllimin për të krijuar familje.

Bazuar në dispozitat ligjore, marrëdhënia faktike (bashkësia jashtëmartesore) konsiderohet marrëdhënie në mes burrit dhe gruas të cilët jetojnë si qift, e karakterizuar nga jeta e përbashkët që përfaqëson një karakter të stabilitetit dhe vazhdueshmërie.

Të drejtat e bashkëshortëve në martesë dhe bashkësi jashtëmartesore janë diskutuar më poshtë.

Prona e përbashkët e bashkëshortëve është:

- pasuria e fituar me punë gjatë rrjedhës së martesës, si dhe të ardhurat e realizuara nga prona e tillë;
 - pasuria e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit;
- Bashkëshortët janë pronarë në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët përveç nëse janë dakorduar ndryshe.
- Për shembull: JU dhe bashkëshorti i juaj (së bashku) jeni pronarë të pronës së lëvizshme dhe/apo palëvizshme të fituara gjatë martesës, siç janë: banesa, toka, ari dhe/apo paratë, etj.*

Prona e ndarë e bashkëshortëve është:

- prona që i takon bashkëshortit në kohën e lidhjes së martesës;
- prona e fituar gjatë martesës me anë të trashëgimisë, dhurimit apo formave tjera të përvetësimit të ligjshëm të përcaktuara në ligj;
- prona që i takon bashkëshortit nga ndarja e pasurisë së



tyre të përbashkët;

- në disa raste, punimet artistike, puna intelektuale ose prona intelektuale.

Secili bashkëshort në mënyrë të pavarur e administron dhe e posedon pasurinë e tij/saj të veçantë gjatë rrjedhës së martesës.

Për shembull: Nëse JU e trashëgoni një shtëpi gjatë martesës suaj dhe keni qiraxhinj në atë shtëpi, shtëpia dhe qiraja që ata paguajnë, mbetet si pronë e ndarë e bashkëshortit. Kështu, edhe pse ju e keni fituar këtë pronë gjatë martesës – ju e keni në pronësi dhe administroni atë ndaras dhe në mënyrë të pavarur prej partnerit tuaj.

Kur mundet bashkëshorti të ndaj pasurinë e përbashkët?

Në çdo kohë bashkëshortët mund të ndajnë pasurinë e tyre të përbashkët, qoftë nga:

- Ndarja me marrëveshje-ku me një marrëveshje me shkrim bashkëshortët përcaktojnë pjesët e tyre në pronën e tyre të përbashkët dhe bëhen bashkë-pronarë të pjesëve të veta të përcaktuara;
- Ndarja me urdhër nga gjykata - ku, një gjykatë përcakton pjesët pronësore të bashkëshortëve në përputhje me kriteret dhe në procedurën e parashikuar me ligj.

Por unë jam një amvisë, nënë dhe kujdesem për fëmijët e mi dhe kurrë nuk punoj jashtë shtëpisë - A kam të drejta pronësore?

PO! Edhe nëse ju kurrë nuk keni qenë e punësuar dhe paga e burrit tuaj është e ardhur e vetme e familjes, e ardhura e tij është pronë e përbashkët. Nëse vendos të shkurorëzohesh ose të ndash pasurinë për çfarëdo arsye, gjykata do të ndajë pronën e përbashkët dhe do të caktojë pjesën e kësaj prone për ty. Gjykata duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat dhe të konsiderojë jo vetëm të ardhurat personale dhe pasuritë e secilit bashkëshort, por dhe kontributet e bëra nga secili bashkëshort, siç janë kujdesi ndaj fëmijëve; punët eshtëpisë; kujdesi dhe mirëmbajtja e pasurisë; dhe çfarëdo forme e punës dhe bashkëpunimit në përvetësimin e pronësive së përbashkët.

A zbatohen këto të drejta edhe për gratë nga martesat tradicionale, të cilat nuk janë regjistruar ligjërisht?

PO! Ligji gjithashtu njih dhe rregullon pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve në një martesë tradicionale, ku martesë nuk është regjistruar ligjërisht.

Sipas ligjit “një marrëdhënie faktike (bashkësi jashtëmartesore) është e barabartë me një martesë të regjistruar ligjërisht. Me pak fjalë, rregullat në lidhje me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve që zbatohen për bashkëshortët e regjistruar ligjërisht zbatohen edhe për ato martesë tradicionale të paregjistruara (bashkësi jashtëmartesore).

A mund të vihet emri im në regjistrin e pronësisë së bashku me bashkëshortin tim si pronar? Pse është e rëndësishme?

PO! Ligji parashikon që “pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë është e regjistruar në regjistrin publik, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve” dhe se “[...] puna e të dy bashkëshortëve me të cilën prona e përbashkët është krijuar, konsiderohet kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët”. Prona e përbashkët e regjistruar administrohet bashkërisht dhe nuk mund të merret nga një bashkëshort, pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve.


4. Ndihma ligjore dhe të drejtat tuaja

Çka duhet të bëj nëse të drejtat e mia shkelen? Si të kuptoj nëse unë jam i diskriminuar dhe çka mund të bëjë për atë?

Diskriminimi ndodh kur JU jeni trajtuar më pak favorshëm se sa personi tjetër, në një situatë krahasuese, për shkak të gjinisë, moshës, statusit martesor, gjuhës, paaftësisë mentale apo fizike, orientimit seksual, përkatësisë ose bindjes politike, religjionit apo besimit, racës, origjinës sociale, pasurisë, lindjes apo çfarëdo statusi tjetër.

Nëse JU mendoni se JU keni qenë të diskriminuar, paraqitni një ankesë. Pasi që JU të keni paraqitur ankesë, barra e provës është në dorë të autoriteteve relevante për të dëshmuar të kundërtën. Nëse diskriminimi është dëshmuar, autoriteti kompetent mund të vendosë gjoba ose të japë lehtësim tjetër palës së dëmtuar. Diskriminimi në kontekstin e rasteve pronësore mund të ndodhë kur JU përpiqeni të regjistroni pronën në emrin tuaj dhe autoriteti kompetent refuzon të bëjë regjistrimin pa asnjë bazë ligjore. Diskriminimi gjithashtu mund të ndodhë në procedurat gjyqësore nëse juve nuk ju jepet një mundësi për tu dëgjuar dhe nuk ju jepet mundësia për të shprehur dëshirën tuaj për ta trashëguar pronën tuaj.

Diskriminimi në baza gjinore për qasje në strehim dhe të gjitha format e pronësisë është në kundërshtim me ligjin. Nëse besoni se ju jeni diskriminuar, ju keni të drejtë të ankoheni si dhe të kërkonin ndihmë juridike (shiko më poshtë).



Por si ti ndjek të drejtat e mia kur nuk kam para për një avokat?

Kosova ka krijuar një sistem për ndihmë juridike falas në rastet civile, administrative, kundërvajtje dhe rastet penale për të siguruar qytetarët të cilat nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për qasje në drejtësi. Ndihma ligjore falas është një e drejtë për shërbime profesionale juridike për qytetarët e Kosovës. Për të pasur qasje në ndihmë juridike falas, qytetarët duhet të përmbushin disa kriteret të caktuara të përshtatshmërisë sipas ligjit.

Ndihma juridike falas, mund të përfshijë:

- informacion dhe këshilla ligjore lidhur me procedurat ligjore;
- hartimin e letrës - punës dhe ndihmë tjetër teknike që ka të bëjë me paraqitjen e një ankese dhe/ose përfundimin e një çështjeje;
- përfaqësimin në rastet civile, administrative dhe kundërvajtje;
- mbrojtjen dhe përfaqësimin në të gjitha fazat e procedurës penale;
- informacion dhe këshilla ligjore lidhur me procedurat gjyqësore;
- informata, këshilla ligjore dhe ndihmë në procedurën e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit siç parashikohet nga ligji; (*Ndërmjetësimi dhe arbitrazhi janë mekanizma joformal për zgjidhjen e një rasti jashtë gjykatës me përdorimin e një pale të tretë neutrale*).

Për të pasur qasje në ndihmën juridike falas JU duhet të paraqisni kërkesën në zyrën më të afërt të ndihmës ligjore. Zyrtarët e zyrës për ndihmë juridike janë të obliguar që t'ju këshillojnë rreth ndihmës juridike falas dhe procesin e aplikimit. Telefononi Agjencinë për ndihmë juridike falas, në: 038 200 189 36 ose kërko faqen e saj zyrtare të internetit në: <http://www.knj-rks.org> dhe mësoni më shumë për

ndihmën juridike që ju mund të merrni në zyrën tuaj më të afërt të Ndihmës Juridike Falas.

5. Dini të drejtat TUAJA

Pse është e rëndësishme për mua t'i mësoj të drejtat e mia?

PO! Për të realizuar të drejtat TUAJA është me rëndësi jetike që JU t'i dini të drejtat TUAJA. Edhe në qoftë se JU keni një avokat apo keni të drejtë për ndihmë juridike falas është shumë e rëndësishme që JU të familjarizoheni me të drejtat TUAJA pronësore dhe të drejtat tjera relevante. Edhe pse ndoshta JU do ta gjeni të vështirë të kuptoni gjuhën ligjore teknike në disa ligje, është e rëndësishme që JU të konsultoheni me këto ligje për të kuptuar se cilat janë të drejtat tuaja. JU duhet të jeni avokat më i mirë i vetës tuaj.

Për t'i mësuar të drejtat tuaja pronësore konsultohuni me:

- Kushtetutën e Kosovës;
- Ligjin për Barazi Gjinore të Kosovës;
- Ligjin për Familjen të Kosovës;
- Ligjin e Trashëgimisë;
- Ligjin mbi Pronën dhe të Drejtat Tjera Sendore;
- Ligjin Kundër Diskriminimit;
- Ligjin për Ndihmë Juridike Falas.

Këto ligje janë publikuar dhe janë në dispozicion në kopje fizike si dhe në kopje elektronike në pesë gjuhë: shqipe, angleze, serbe, turke dhe boshnjake. Kopja elektronike e Gazetës Zyrtare ku këto ligje janë të publikuara është e qasshme në internet: <http://gazetazyrtare.rks-gov.net> Nëse ju nuk keni qasje në internet kontaktoni Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas të përmendur më lart.

Familjarizohu me të drejtat tuaja – Për të qenë në gjendje të mbrosh të drejtat tuaja; Të vendosësh vetë; dhe të sigurohesh që ju i kuptoni opsionet tuaja dhe të vendosësh çfarë është më e mira për ju.

“Gratë nuk duhet të heshtin, ato duhet të thonë fjalën e tyre për ndarjen e barabartë të pasurisë nga gjykatat.” Lavdim Krasniqi, Drejtor, Instituti Gjyqësor i Kosovës



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosuđe
Kosovo Judicial Institute
<http://igjk.rks-gov.net>



Autore: Arijeta KELMENDI, M.A. Të Drejtat e Njeriut dhe Demokraci¹; Editimi dhe Dizajni nga Mary AGUIRRE-SHAHIN, Këshilltare Speciale e OSBE-së për Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) dhe koordinuar nga Lumnije KRASNIQI, Koordinatorë e Programit në IGJK

¹ Arijeta Kelmendi aktualisht shërben si Zyrtare për të Drejtat e Njeriut në EULEX, Kosovë.